



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs

Mbështetur në nenin 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 5.10 të Ligjit për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin në Kosovë dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake dhe Personelin e saj, dhe

Në pajtim me nenin 25.7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministri i Punëve të Jashtme nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV 07/2009 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr. 002/2008
PËR PAJISJEN ME TABELA TË REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE PËR
MISIONET DHE PERSONELIN ME STATUS DIPLOMATIK DHE KONSULLOR NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet pajisja me tabela të regjistrimit të automjeteve të Misioneve dhe Personelit me status Diplomatik dhe Konsullor në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Regjistrimi, pajisja me tabela dhe leje të qarkullimit për automjetet e Misioneve dhe Personelit me status Diplomatik dhe Konsullor të akredituara në Republikën e Kosovës, si dhe Misionet e tjera me status Diplomatik të akredituar, bëhet pas pajisjes me Kartelë Diplomatike dhe Shërbimi.

Neni 3

Forma dhe përmbajtja e tabelës

3.1 Forma dhe madhësia e tabelave të regjistrimit të automjeteve është e njëjtë me tabelat e rregullta që përdoren në Republikën e Kosovës sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2008 të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

3.2 Tabela e regjistrimit të automjetit për Misionet dhe Personelin me status Diplomatik dhe Konsullor në Republikën e Kosovës ka parametrat si në vijim:

- Sfondi – ngjyra e targës: bazë e zezë (100%);
- Ngjyrat e numrave dhe shifrave të strukturuar: Ngjyrë hiri (për targat CD - ngjyrë hiri-10% ngjyrë e zezë);
- Ngjyrat e numrave dhe shifrave të strukturuar: Ngjyrë hiri(për targat- CC- ngjyrë hiri-30% ngjyrë e zeze);
- Formati i targave horizontale: 520x110 mm;
- Formati i targave katërkëndëshe:340x220mm;
- Shenja identifikuese e Republikës së Kosovës me initiale “RKS”;
- Numri i shtetit nga është përfaqësia;
- Pozita e personelit në atë përfaqësi;
- Numri i tabelës së regjistrimit të automjetit.

3.3 Shenja dhe shkronja në tabelë të regjistrimit të automjetit të Misionit dhe Personelit me status Diplomatik dhe Konsullor janë:

- (i). CD për automjetet në pronësi të Misionit Diplomatik në Republikën e Kosovës,
- (ii). CC për automjetet në pronësi të Misionit Konsullor në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Pajisja me tabela të regjistrimit

4.1 Ministria e Punëve të Jashtme pajis me Kartelë Diplomatike dhe Shërbimi personin me status Diplomatik dhe Konsullor në Republikën e Kosovës, i cili parashtron kërkesë për pajisjen me tabelë të regjistrimit të automjetit.

4.2 Prodhimi i tabelave të regjistrimit të automjeteve të Misioneve dhe Personelit me status Diplomatik dhe Konsullor dhe lëshimi i tyre bëhet në Departamentin e Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shoferëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas nenit 304.1.(e) të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.

4.3 Kërkesa dhe procedura për pajisjen me tabela të regjistrimit CD ose CC të automjeteve bëhet sipas nenit 11 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 5

Numri i automjeteve

5.1 Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor mund të importojnë apo të blejnë në vend automjete për përdorim.

5.2 Numri i automjeteve duhet të jetë i arsyeshëm në varësi të madhësisë dhe nevojave të misionit, mirëpo numri i tyre nuk mund të kalojë numrin e stafit diplomatik të tij.

Neni 6

Importi dhe blerja e automjeteve për Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor

6.1 Shefat e Misioneve me status Diplomatik dhe Konsullor me marrëveshje dypalëshe me institucionet e Republikës së Kosovës, mund të importojnë apo të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, dy automjete për përdorim personal, ku njëra konsiderohet për bashkëshorten/in, të cilëve u jepet tabelë e regjistrimit CD ose CC.

6.2 Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, ekskluzivisht për përdorim të tyre, një automjet.

6.3 Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor mund të blejë automjet tjetër shtesë, i cili importohet ose blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nëse personeli është i shoqëruar nga bashkëshorti/ja, të cilëve u jepet tabelë e regjistrimit të automjetit CD ose CC.

Neni 7

Importi dhe blerja e automjeteve nga agjencitë e specializuara të OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të akredituara në Kosovë

7.1 Shefat e agjencive të specializuara të OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Kosovës mund të importojnë apo të blejnë në vend në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet për përdorim personal, të cilës i jepet tabelë e regjistrimit CD.

7.2 Një automjet tjetër shtesë mund të përdoret ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nëse ata janë të shoqëruar nga bashkëshortja/i, të cilës i jepet tabelë e regjistrimit CD.

7.3 Personeli i organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB-së mbajtës të pasaportave diplomatike mund të importojnë apo të blejnë në vend në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet për përdorim personal, të cilës i jepet tabelë e regjistrimit CD.

7.4 Një automjet tjetër shtesë mund të përdoret ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nëse ata janë të shoqëruar nga bashkëshortja/i, të cilës i jepet tabelë e regjistrimit CD.

Neni 8
Importimi i automjetit për herë të parë në vend

8.1 Kur importohet një automjet për herë të parë, një Mision dhe Personel me status Diplomatik dhe Konsullor duhet të paraqesë automjetin për kryerjen e veprimeve doganore.

8.2 Shërbimi Doganor i Republikës së Kosovës bën regjistrimin e hyrjes së automjetit në Republikën e Kosovës, si dhe vërtetimin e datës së importimit.

Neni 9
Shitja e automjeteve

9.1 Në rastin kur automjeti shitet brenda Misioneve dhe Personelit me status Diplomatik dhe Konsullor ose midis tyre, nota verbale e dërguar në Protokollin e Shtetit, duhet të shoqërohet nga fotokopjet e Kontratë Shitblerjes, Leje Qarkullimi të lëshuar nga Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shoferëve i Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe fotokopja e Kartës së identitetit të personave që kanë bërë shitblerjen në rastin kur automjeti është për përdorim personal.

9.2 Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor mund të shesë një automjet të importuar pa doganë, qoftë ajo edhe e shërbimit zyrtar apo personal, pas kalimit të një periudhe kohe, minimumi 6 muaj nga importimi pa doganë ose nga shitja e fundit pa doganë e një automjeti, mbi bazën e reciprocitetit.

9.3 Shitja e automjeteve të importuara pa doganë nga Misionet dhe personeli me status Diplomatik dhe Konsullor, qofshin ato zyrtare apo personale, mund t'i bëhet, pas periudhës së përcaktuar në paragrafin 9.3, edhe subjekteve që nuk gëzojnë imunitete dhe privilegje diplomatike. Të gjithë këta subjekte më pas duhet t'i nënshtrohen ligjeve të aplikueshme në Kosovë për dogana dhe regjistrim të automjeteve.

Neni 10
Bartja e automjeteve

10.1 Një Mision dhe Personel me status Diplomatik dhe Konsullor në Republikën e Kosovës mund të bartë një automjet të importuar pa taksa doganore dhe taksa të tjera tek Misioni dhe Personeli tjetër me status Diplomatik në Republikën e Kosovës.

10.2 Veprimi i paraparë nga neni 10.1 bëhet pasi të jetë bërë njoftimi dhe veprimi përkatës të regjistrimit në Departamentin e Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shoferëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Neni 11
Parashtrimi i notës verbale për pajisjen me tabelë të regjistrimit

11.1 Parashtrimi i notës verbale për pajisjen me tabelë regjistrimi bëhet në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

11.2 Nota verbale përmban si vijon:

- i. Emrin dhe mbiemrin e parashtruesit të notës verbale - pronarit,
- ii. Fotokopja e Kartelës Diplomatike dhe Shërbimit
- iii. Llojin e automjetit, numrin e shasisë, ngjyrën e tij,
- iv. Fotokopja e vërtetimit të zhdoganimit, fatura e zhdoganimit, vërtetimin e hyrjes së automjetit të lëshuar nga dogana.

11.3 Pas miratimit të notës verbale nga Ministria e Punëve Jashtme, Zyra e Protokollit, dorëzon këtë notë verbale në Departamentin e Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shoferëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 12

Mos lejimi i transferimit të tabelave të regjistrimit

12.1 Tabelat e regjistrimit CD ose CC nuk janë të transferueshme kur automjeti që mban ato shitet ose ndryshon pronësi në çfarëdo lloj mënyre.

12.2 Në rastet kur personeli i Misionit me status Diplomatik dhe Konsullor shet automjetin e tij dhe blen tjetër automjet, tabelat e regjistrimit të automjetit të parë nuk janë të transferueshme tek automjeti i dytë.

Neni 13

Numri i tabelave të regjistrimit

Numri i tabelave të regjistrimit do të jetë në mënyrë progresive me përjashtim të ambasadorit ose përfaqësuesit të Misionit, i cili mban në automjetin e tij zyrtar dhe personal nr. 0001.

Neni 14

Evidenca

Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor, në Republikën e Kosovës, pas pajisjes së automjetit me tabela të regjistrimit CD ose CC, duhet të njoftojë Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për tabelat e pranuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 15

Pajisja me patentë shofer vendor

15.1 Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor në Republikën e Kosovës, pajisen me patentë shofer vendor, mbi bazën e ekuivalencës së dëshmisë që ka misioni i vendit të origjinës.

15.2 Pajisja me patentë shofer vendore bëhet pas qëndrimit më shumë se një vit në Republikën e Kosovës.

15.3 Pajisja me patentë shofer vendor e përcaktuar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet në Departamentin e Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shoferëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Neni 16 **Sigurimi i automjetit për palë të treta**

Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor në Republikën e Kosovës duhet të bëjnë sigurimin e automjetit për palë të treta.

Neni 17 **Denoncimi**

17.1 Në rastet kur vidhet automjeti, duhet të bëhet menjëherë denoncimi në Stacionin e Policisë, si dhe të njoftohet Zyra e Protokollit e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

17.2 Në rastet kur humbet tabela e regjistrimit të automjetit, duhet të bëhet menjëherë denoncimi në Stacionin e Policisë dhe të njoftohet Zyra e Protokollit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, shoqëruar me fotokopjen e procesverbalit të denoncimit.

17.3 Denoncimi çdo herë duhet të shoqërohet me fotokopjen e procesverbalit të denoncimit.

Neni 18 **Kthimi i tabelave**

18.1 Misionet dhe Personeli me status Diplomatik dhe Konsullor që largohen përfundimisht nga Republika e Kosovës duhet të kthejnë tabelat e regjistrimit të automjeteve CD ose CC, si dhe Lejen e Qarkullimit.

18.2 Kthimi i tabelave sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet me notë verbale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme me procedurë të njëjtë të marrjes se tabelave të regjistrimit të automjetit.

18.3 Zyra e protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme njoftohet me notë verbale, e cila shoqërohet nga fotokopja e dokumentit të reregjistrimit, lëshuar nga Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shoferëve.

Neni 19

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Skender Hyseni

Ministër i Punëve të Jashtme

Prishtinë, 20 tetor 2009